



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE  
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 401..... Prot.

Tiranë, më 27.01.2025

**URDHËR**

Nr. 12, Datë 27/01/2025

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR MATURËN SHTETËRORE DHE MATURËN SHTETËRORE PROFESIONALE 2025**


Në mbështetje të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, të Urdhrit të përbashkët të Ministrit të Arsimit e Sportit dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.661, datë 01.12.2023, "Për miratimin e Rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr.1, datë 09.01.2025, "Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2025",

**URDHËROJ**

1. Miratimin e kalendarit për Maturën Shtetërore 2025, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet arsimore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**



Referenca Urdhri nr. 661, datë 01.12.2023, “Për miratimin e Rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar	Periudha/Datat
<b>Kreu II</b> <b>Institucionet dhe strukturat përgjegjëse për zhvillimin e provimeve të maturës</b>	
Neni 7, pika 15	Dërgon në QSHA, brenda datës 17 mars 2025, listën e qendrave për provimet e Maturës Shtetërore.
Neni 8, shkronja “m”	Plotëson brenda datës 28 prill 2025, bazën e të dhënave për maturantët/kandidatët për të gjitha vitet e shkollës së mesme, me përjashtim të vitit të fundit. Secilit maturant/kandidat i jepet një kopje e printuar e rezultateve të hedhura, të firmosura nga maturanti/kandidati, të vulosura dhe të firmosur nga drejtori i shkollës dhe kopja tjetër ruhet në arkivin e shkollës.
Neni 8, shkronja “n”	Plotëson në periudhën 2 – 13 qershor 2025, bazën e të dhënave për maturantët/kandidatët për vitin e fundit të shkollës së mesme.
Neni 8, shkronja “p”	Në periudhën 16 – 20 qershor 2025 përfundon procesin e verifikimit dhe konfirmimit të rezultateve në sistem.
<b>Kreu IV</b> <b>Aplikimi për provimet e maturës</b>	
Neni 13, pika 2	Maturanti/kandidati bën aplikimin online, fillimisht në Portalin Qeveritar e-albania dhe më pas, në sistemin “e-Matura”, në periudhën 3 shkurt – 12 shkurt 2025. Aplikimi në sistemin “e-Matura”, bëhet edhe sipas afateve të vendosura nga QSHA.